VENDIM
Nr.588, datë 18.8.2011

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2011, MIRATUAR PËR INSTITUTIN E STATISTIKAVE, PËR ORGANIZIMIN DHE ZBATIMIN E PROJEKTIT TË CENSUSIT TË PËRGJITHSHËM TË POPULLSISË DHE BANESAVE, SI DHE LEJIMIN E SHTYRJES SË AFATIT TË KRYERJES SË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të nenit 13 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 "Për buxhetin e vitit 2011", të ndryshuar, të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.8669, datë 26.10.2000 "Për regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë dhe të banesave", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Institutit të Statistikave, në buxhetin e miratuar për vitin 2011, në artikullin 231 (fond page), t'i shtohet fondi me shumën 47 100 000 (dyzet e shtatë milionë e njëqind mijë) lekë dhe në artikullin 602 (shpenzime operative), fondi me shumën 31 000 000 (tridhjetë e një milionë) lekë, për organizimin dhe zbatimin e projektit të censusit të përgjithshëm të popullsisë dhe banesave.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.
3. Lejimin e shtyrjes së afatit të kryerjes së procedurave të prokurimit për Institutin e Statistikave.
4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Instituti i Statistikave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha